



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0692

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim- Kryesues, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Brajshori, Anëtar të panelit shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Samire Osmani, kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: 34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës -RITENDER me numër të prokurimit 616-24-4214-2-1-1, me 18/10/2024 mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e OE Samire Osmani me nr. 2024/0692, e datës 01/08/2024, kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit 34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës -RITENDER me numër të prokurimit 616-24-4214-2-1-1 , mbetet në fuqi vendimi i AK-se per anulimin e aktiviteti të prokurimit.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Samire Osmani.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 29.04.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 12.07.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim me vlerë të parashikuar të kontratës 50,000.00

Me 16.07.2024, OE Samire Osmani ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 23.07.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 01.08.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Samire Osmani me numër protokolli 2024/0692 lidhur me aktivitetin e prokurimit 34 Dezinfektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës -RITENDER me numër të prokurimit 616-24-4214-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Samire Osmani janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet ankimore ndaj grupit të Samire Osmani B.I., Besim A. Zejnullahu B.I., Vlora A. Ahmeti B.I., dhe Haxhi H. Gashi B.I. Arsyet e paqëndrueshme për eliminim: Pretendimet tona ankimore janë si në vijim:

Pretendimi i parë (1) : “Autoriteti Kontraktues (AK) ka vendosur për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit me pretendimin se të gjithë tenderuesit janë të papërgjegjshëm, që është i pabazuar. Vlerësimi i ofertës sonë është i gabuar dhe arsyet që keni cekur në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar janë të paqëndrueshme, siç do tju dëshmojmë si në vijim: Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 & 7.2: Përshtatshmëria profesionale: 3.Operator Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga MBZHR për kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit të Republikës së Kosovës. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kopja e licencës valide. Ne si GOE kemi plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe DT në kërkesat e përshtatshmërisë profesionale Neni 7.1 dhe 7.2, ku kërkohet Licenca nga MBZHR për kryerjen e shërbimeve DDD brenda territorit të Republikës së Kosovës. Ky kriter është i plotësuar nga ana jonë si GOE, pasi sipas Ligjit për Prokurim Publik (LPP) Neni 71.4, çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të grupit. Licenca i përket Nenit 66.2; andaj

kërkesa e juaj që ne si GOE të posedojmë licencën secili anëtar veç e veç është në kundërshtim me Nenin 71.4. Prandaj, akuzat që nuk e plotësojmë këtë kriter janë të padrejta. Nëse DT do të kishte cekur se secili nga anëtarët e GOE duhet të posedojë licencën për DDD, do të kishit të drejtë tani, por kjo nuk është bërë, dhe andaj duhet të respektohet Neni 71 i LPP-së. Për këtë aktivitet të prokurimit, OE Samire Osmani B.I ka kërkuar interpretim nga KRPP-ja më datë 30.05.2024 (shihni dëshminë e bashkëngjitur në attach), ndërsa KRPP-ja, përmes Referencës Nr. KRPP-DRR-07-06-88/2024 të datës 07.06.2024, e ka miratuar në tërësi pretendimin tonë ankimor. Për më shumë, referojeni interpretimit në attach ku në mënyrë të qartë mbështetet pretendimi ynë ankimor. Po ashtu, ju si AK, në vendimin për refuzim, jeni treguar të pasaktë pasi keni thënë se kërkesën e drejtuar KRPP-së e kam bërë sipas dëshirës, por ky pretendim nuk qëndron. Kam elaboruar konkretisht këtë procedurë në mënyrë të detajuar dhe profesionale, ndërsa ju si AK përpiqeni të mbuloni shkeljet e rënda që keni bërë me akuza të pabaza. Prandaj, besoj fuqishëm se pretendimet tona ankimore do të shqyrtohen në mënyrë të merituar nga OSHP-ja.”

Pretendimi i dytë (II) : AK në DT të Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 & 7.2: 4.Leja për importim të produkteve biocide nga MMPH. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kopja e Lejes për importim të produkteve biocide. Arsytimi i dytë i juaj për eliminim është i pabazuar, pasi që njëjtë si në arsyetimin e parë, sipas LPP Neni 71.4 sqaron se çfarë duhet të posedojnë të gjithë anëtarët e GOE-së në rast të tenderimit. Po e shënjojmë sërish: "Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji". Këtë kërkesë të LPP-së ne e plotësojmë. Ndaj vendimi i juaj është i gabuar. Edhe për këtë pikë ju nuk keni kërkuar në DT që secili nga anëtarët e GOE duhet të plotësojë këtë kriter, andaj duhet të respektohet LPP Neni 71.4. Po ashtu, keni kërkuar që leja e importit të produkteve biocide të jetë konform lejës së importit. Kjo është e pa-logjikshme dhe e pabazuar në ligje, pasi që leja për import mund të jetë e përbashkët për gjithë grupin dhe jo secili anëtar i konsorciumit të ketë leje të veçantë për import. Ky kriter nuk është specifikuar qartë nga AK që secili anëtar i konsorciumit duhet të plotësojë këtë kriter. Thënë shkurt dhe qartë, edhe interpretimi i KRPP-së Nr. KRPP-DRR-07-06-88/2024 të datës 07.06.2024, si dhe duke u bazuar në dispozita ligjore, ky arsyetim për eliminim është i paqëndrueshëm, andaj kërkojmë nga ekspertit i OSHP-së dhe OSHP-ja të bëjë një vlerësim të merituar dhe profesional.”

Pretendimi 3: Autoriteti Kontraktues në FTD ka kërkuar në Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 & 7.2: 5.Operator Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO standard 9001:2015, 14001:2015, 45001:2018. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kopja e certifikatave - valide dhe të noterizuara. Ne si Grup i Operatorëve Ekonomik kemi dorëzuar konform kërkesave në FTD certifikatat ISO Standarde. Pra, lideri i konsorciumit dhe një anëtar i konsorciumit janë të certifikuar me ISO standarde për aktivitetin e prokurimit, ndërsa një anëtar tjetër i konsorciumit nuk është i certifikuar me ISO standarde. Autoriteti Kontraktues në FTD nuk e ka bërë të qartë se edhe anëtari i konsorciumit duhet të jetë i certifikuar me ISO standarde, andaj ne si konsorcium e plotësojmë këtë kriter ashtu siç e ka kërkuar në FTD nga Autoriteti Kontraktues.

Edhe arsyetimi i tretë i juaj në letrën standarde për eliminimin e ofertës tonë si GOE është i pabazuar për të njëjtën arsye siç u cek më lart. Ju në DT nuk keni kërkuar që GOE duhet të plotësojë këtë kriter secili anëtar veç e veç, andaj nuk mund të merrni për bazë gjatë vlerësimit të ofertave diçka që nuk është specifikuar mirë në DT. Bazuar në Nenin 71.4 të LPP-së, ne si OE kemi dorëzuar me ofertë certifikatat e kërkuara në emër të grupit. Sipas këtij neni, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të grupit.”

Pretendimet Ankimore ndaj Grupit të OE Doctor Extermintor Ddd Sh.P.K & Ddd Sh.P.K:

Pretendimi i parë (I) : “Aneksi 1. Specifikimet teknike të detyrueshme Projekti është paraparë të kryhet në gjashtë faza me një interval kohor mes tyre prej 7-14 ditësh nga dita e përfundimit të fazës paraprake (me mundësi të shkurtimit ose zgjatjes së këtij intervali 14 ditor, varësisht nga situata epidemiologjike). Realizimi i një faze duhet të kryhet brenda afatit prej 4-5 ditësh pune (deklarim me shkrim nga OE mbi realizimin e fazës brenda kohës së kërkuar) me qëllim që të arrihet mundësia e eliminimit edhe të atyre insekteve që do të zhvillohen nga forma e tyre larvare në ndërkohë. Nëse merret parasysh edhe koha tjetër e nevojshme për përgatitje adekuate, i tërë projekti do të zgjasë afër katër (4) muaj, gjatë një viti. Grupi i OE Doctor Extermintor Ddd Sh.P.K & Ddd Sh.P.K nuk posedon një deklaratë të tillë. Po ashtu, sipas RREGULLORJES Nr. 001-2022 Neni 19.11, thotë qartë që: "Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm." Andaj, AK në vendimin e fundit nuk e ka përmendur këtë arsye për eliminim nga ky GOE.”

Pretendimi i dytë (II): “ Te Aneksi 7. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm: Pika 4. Automjete pune për vendosjen e pompave, gjeneratorëve ULV dhe pompave motorike për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit hapësinor të jashtëm. Automjetet duhet të jenë të pajisura me GPS monitorues (pick-up ose kamionetë). Grupi i OE Doctor Extermintor Ddd Sh.P.K & Ddd Sh.P.K nuk ka paraqitur dëshmi se automjetet e tyre janë të pajisura me GPS, pra nuk kanë dëshmuar me platformë të monitorimit. Po ashtu, në Nenin 1 të kontratës që kanë ofruar (kontrata me TMS Mobile) shkruan se GPS do të instalohen, pra me këtë dëshmohet se automjetet nuk kanë të instaluar GPS. Në Aneksin 7, Pika 4, shkruhet se: "Automjetet duhet të jenë të pajisura me GPS monitorues." Grupi i OE Doctor Extermintor Ddd Sh.P.K & Ddd Sh.P.K nuk ka ofruar dëshmi se automjetet kanë qenë të pajisura me sistemin monitorues GPS para datës së hapjes së ofertave. Po ashtu, në kontratën e lidhur mes Tms Mobile Sh.P.K Dhe Doctor Extermintor Ddd Sh.P.K, në Nenin 4.8, shkruan qartë se: "Ofruesi i shërbimit do të bëjë instalimin e pajisjeve GPS në instalimin ekzistues të automjetit sipas praktikave dhe rekomandimeve të prodhuesit Arvento." Pra, edhe në kontratë shkruan që do t'i vendosin, mirëpo nuk i posedojnë në momentin e aplikimit. AK mund të kërkojë nga kompania TMS MOBILE SH.P.K dëshmi se automjetet kanë qenë të pajisura me sistemin monitorues GPS para datës 20.05.2024 dhe të ofrojë dëshmi që sistemi i monitorimit ka qenë aktiv para datës së hapjes së ofertave.”

Pretendimi i tretë (III) : “ Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 3. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 3. Lista e pajisjeve sipas tabelës në Aneksin 7 të DT duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve. Grupi i OE Doctor Extermintor Ddd Sh.P.K & Ddd Sh.P.K nuk e ka plotësuar tabelën sipas Aneksit 7 Pajisjet dhe Mekanizimi I Obligueshëm. Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe t’i bashkëngjiten dëshmitë e kërkuara në FTD. Pra, ky Aneks është obligativ dhe Grupi i OE Doctor Extermintor Ddd Sh.P.K & Ddd Sh.P.K nuk e ka bërë një gjë të tillë. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Dëshmitë e kërkuara: 3. Lista e pajisjeve sipas tabelës në Aneksin 7 të DT duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve. Grupi i OE Doctor Extermintor Ddd Sh.P.K & Ddd Sh.P.K nuk ka dorëzuar Aneksin 7 të DT siç është kërkuar në dosjen e tenderit, mirëpo ka dorëzuar një Listë të Pajisjeve jo sipas kriterëve të DT-së. Pra, GO nuk e plotëson këtë kriter të përcaktuar në FDT, i cili është Aneks obligativ që të plotësohet nga Operator Ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomikë. Sipas legjislacionit në fuqi të LPP-së dhe RREGULLORIT, nëse një tender nuk e plotëson këtë kriter, atëherë Autoriteti Kontraktues duhet të shpallë si tenderues të papërgjegjshëm. Mirëpo, AK në këtë rast, përkundër shumë kriterëve të pa plotësuar, ka bërë favorizime të qarta ndaj GO-së dhe ka vepruar në mënyrë diskriminuese. Për këtë diskriminim do të bëjë të qartë në një pretendim të mëvonshëm.”

Pretendimet Ankimore ndaj OE Trolley Nolen Sh.P.K., në Procesverbalin e hapjes së tenderit, shihet se ka plotësuar gabim Formularin e tenderit.

Pretendimi i parë (I) : “Në seksionin e çmimit, ka vendosur vlerën 85,860.00 euro, ndërsa në çmimin total me TVSH ka vendosur 562,860.00 euro, që është një gabim për të cilin oferta duhet të refuzohet. Gabimi i tij është se në vend të çmimit ka shënuar vetëm TVSH-në e çmimit total, në vend se të shënonte çmimin pa TVSH, siç përcaktohet në Nenin 40, pika 10 e Rregullores 001.2022 për Prokurim Publik, respektivisht pika b dhe c, e cila përcakton që në rast të mos përputhjes mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrimin e çmimit, oferta duhet të refuzohet. Andaj, AK nuk e ka cekur këtë gabim si arsye për eliminimin e Trolley Nolen SH.P.K. Sipas Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik, pika 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve: Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmit raste. Varësisht nga rasti i paraqitur, AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së. Faqe 40 dhe 41. Mirëpo, AK nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat dhe ligjet e LPP-së dhe RREGULLORES dhe e ka shpallur të përgjegjshëm një OE që duhet të ishte i pa përgjegjshëm. QUDIA është se i njëjti AK, me datë 07.11.2023 për aktivitetin e ngjashëm të prokurimit me titull “Deratizimi për nevojat e kujdesit Shëndetësor” Nr. Prok 616-22-10416-2-1-1, na ka shpallur ne si OE të pa përgjegjshëm me ARSYETIMIN si në vijim: “Tenderi juaj është administrativisht i pa përgjegjshëm.” Ndërsa tani, Trolley Nolen SH.P.K për aktivitetin e tanishëm

nuk është shpallur administrativisht i pa përgjegjshëm dhe kjo nuk ka mundur të ikë Komisionit të vlerësimit. Mirëpo, këtu shifet qartazi favorizimi për OE të caktuar nga AK. PROVE: 1. Procesverbalin e Hapjes së Tenderit të datës 20.05.2024. 2. Vendimin mbi AK të datës 07.11.2023, faqja 4.

Pretendimi i dytë (II) : “ Në Aneksin 7. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm, pika 4, kërkohet: “Automjete pune për vendosjen e pompave, gjeneratorëve ULV dhe pompave motorike për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit hapësinor të jashtëm. Automjetet duhet të jenë të pajisura me GPS monitorues (pick-up ose kamionetë).” OE Trolley Nolen Sh.P.K nuk ka sjellë dëshmi se automjetet e tyre janë të pajisura me GPS, pra nuk kanë dëshmuar platformën e monitorimit. Gjatë qasjes në dokumente zyrtare, ky Operator Ekonomik fare nuk ka paraqitur dëshmi se automjetet e tyre janë të pajisura me GPS, por ka paraqitur një vizatim me disa ngjyra në Google Maps që nuk ka të bëjë me GPS për automjetet. PROVE: 1. Shih si dëshmi se si është platforma e monitorimit e ofruar nga Konsorciumi ynë me rastin e aplikimit. Në këtë platformë janë të paraqitur dëshmitë si: Emri i Automjetit, Numri i Targave të veturës, si dhe lokacioni se ku janë të vendosur këto automjete dhe me këtë rast çdo automjet ka pajisjen e monitorimit funksionale. Andaj, OE Trolley Nolen Sh.P.K nuk ka paraqitur fare se automjetet e tyre janë të pajisura me GPS dhe rrjedhimisht, AK gjatë fazës së vlerësimit është dashur të shpallë të pa përgjegjshëm këtë OE. Mirëpo, edhe këtu Komisioni i vlerësimit fare nuk e ka marrë mundimin që të bëjë një vlerësim profesional për të gjithë Operatorët Ekonomikë ose Grupin e Operatorëve Ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet.

Pretendimi i tretë (III) : “ Në Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme, projekti është paraparë të kryhet në gjashtë faza me një interval kohor mes tyre prej 7-14 ditë nga dita e përfundimit të fazës paraprake (me mundësi të shkurtimit ose zgjatjes së këtij intervali 14 ditor varësisht nga situata epidemiologjike). Realizimi i një faze duhet të kryhet brenda afatit prej 4-5 ditësh pune (deklarim me shkrim nga OE mbi realizimin e fazës brenda kohës së kërkuar) me qëllim që të arrihet mundësia e eliminimit edhe të atyre insekteve që do të zhvillohen nga forma e tyre larvare në ndërkohë. Kjo do të thotë se, nëse merret parasysh edhe koha tjetër e nevojshme për përgatitje adekuate, i tërë projekti do të zgjasë afër katër (4) muaj, gjatë një viti. OE Trolley Nolen Sh.P.K nuk posedon një deklaratë të tillë. Po ashtu, sipas Rregullores Nr. 001-2022, Neni 19.11 thotë qartazi që: “Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t’i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.”

Pretendimet Ankimore nga Samire Osmani B.I & Besim A Zejnullahu B.I & Vlora A.Ahmeti B.I & Haxhi H.Gashi B.I.

Ne si Grup i Operatoreve Ekonomike ne ketë procedure te prokurimit jemi Diskriminuar nga AK dhe AK ka bere favorizime te qarta ndaj disa OE tjerë ekonomike. Pretendimet tona për diskriminim janë si ne vijim : A. Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 & 7.2 3.Operatori Ekonomik duhet te jete i licencuar nga MBZHR për kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit të Republikës së Kosovës Dëshmia e kërkuar dokumentare: 3. Kopja e licencës valide.

B. Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 & 7.2 4. Leja për importim të produkteve biocide nga MMPH Dëshmia e kërkuar dokumentare: 4. Kopje e Lejes për importim të produkteve biocide preparatet duhet të jenë konform lejes së importit. C. Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 & 7.2 5. Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO standard 9001 2015, 14001 2015, 45001 2018. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 5. Kopja e certifikatave - valide dhe te noterizuara Autoritet Kontraktues konform Ligjit të Prokurimit Publike dhe konform RROUPI-te është dashur të veproje sipas kërkesave të përcaktuara në DT dhe FTD dhe jo të kërkoj kritere të paqena që nuk janë të vendosura në DT .Andaj për këtë kemi dëshmi të bollshme edhe nga vendimet paraprake të OSHP-se por edhe një Interpretim nga KRPP-ja që e interpreton në mënyrë shumë të qarta që në si GOE jemi eliminuar në baze të kritere që nuk kanë qene pjesë e DT dhe FDT . Pra Autoriteti Kontraktues konkretisht Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari i Prokurimit në këtë procedurë të prokurimit ka qene i një anëshëm ,tendencioz dhe aspak PROFESIONAL sepse jo vetëm në vlerësimin e ofertës tone që nuk është bere aspak në mënyrë profesionale mirëpo edhe në të gjitha ofertat tjera ka pasur gabime dhe kritere të pa plotësuar nga Operator Ekonomike dhe Grup i Operatoreve Ekonomike që është dashur të shpallen të papërgjegjshëm edhe në disa pika përveç atyre që janë përmendur në vendimin e asaj date 23.07.2024 mirëpo AK ka bere shkelje të rënda me këtë vlerësim aspak profesional dhe tendencioz.”

Duke u referuar kërkesave si më sipër OE Samire Osmani konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 1 ,6 , 7 , 28 , 51 , 52 , 54, 56, 59, 60, 69. 71, 72 të LPP-së. e kërkojmë nga OSHP që proces i prokurimit të kthehet në Rivlerësim dhe si oferte e vetme e përgjegjshme AK të na shpërblejë me Kontrate pasi që me përgjegjësi profesionale deklaroj se asnjë e tillë nuk i plotëson kriteret në Dosje të Tenderit përveç neve si Geo Samire Osmani B.I & Besim A Zejnullahu B.I & Vlora A.Ahmeti B.I & Haxhi H.Gashi B.I.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsye si në vijim: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ju si GOE-ik nuk keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale Neni 7.1 & 7.2 Përshtatshmëria profesionale: pika 3.Operalori Ekonomik duhet të jete t licencuar nga

MBZHR për kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit të Republikës së Kosovës - Dëshmia e kërkuar: 3. Kopjn e licencës vnlide., Ju si GOE-ik me rastin e dorëzimit të ofertës për këtë pike nuk keni dorëzuar Licencën siç është kërkuar në DT dhe njoftim për kontrate. Anëtari III-të i GOE-ik ka dorëzuar licencën me nr Ref. 04.5-558/23 me afat të skaduar (skadimi i licencës është me datë 03.05.2024). Po ashtu edhe anëtari IV-të i GOE-ik nuk ka dorëzuar me oferte dëshmitë sipas kërkesës 3 nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi që posedon licence nga MMPH. Ju si GOE-ik Po ashtu, njëjtë keni vepruar edhe me kërkesën tjetër; Pika 4.Leja për importim të produkteve biocide nga MMPH - Dëshmia e kërkuar: 4. Kopje c Lejes për importim të produkteve biocide preparatet duhet të jenë konform lejes së importit. Anëtari i I-rë, II-të dhe anëtari i III-të i GOE-ik nuk kanë dorëzuar me oferte dëshmitë se posedojnë Leje për import të

produkteve biocid nga MMPH. Ju si GOE-ik Po ashtu nuk keni vepruar konform kërkesave të DT-se kërkesat e përshtatshmërisë profesionale pika S.Operaiort Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO standard 9001 2015,14001 2015.45001 2018. - Dëshmia e kërkuar - 5. Kopjn e certifikatave - valide dhe të noterizuara., Anëtarë i III-të dhe IV-të të GOE-ik nuk kanë dorëzuar fare dokumentacionin e kërkuar për këtë pikë të kërkesës. Andaj për arsye të cekura me lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit. Pas administrimit me ofertën e parashtruesit është gjetur se të gjitha konstatimet dhe të gjeturat e komisionit vlerësues janë të sakta dhe të bazuara në tërësi. Në anën tjetër nga analizimi i pretendimeve ankimore rezulton se të gjeturat e komisionit vlerësues parimisht nuk kontestohen as nga vet parashtruesi. Megjithatë parashtruesi e konteston faktin se kërkesat e përshtatshmërisë në dosjen e tenderit nuk ka nevojë që të plotësohen nga të gjithë anëtarët e GOE por mjafton që të përmbushen vetëm nga njëri anëtar i GOE. Lidhur me këtë fakt duhet cekur nenin 26.4 të RRPP përmes të cilit është përcaktuar se "Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se". Sa i përket interpretimit të KRPP që e potencon parashtruesi duhet cekur se ky interpretim është kërkuar nga vet parashtruesi në mënyrën e formuluar sipas dëshirës së parashtruesit. Rrjedhimisht KRPP interpretimin e ka dhënë për dispozita tjera të LPP dhe jo për nenin 26.4 të RRPP lidhur me nenin 65 të LPP. Përndryshe sa i përket nenit 26.4 të RRPP lidhur me nenin 65 të LPP, OSHP ka nxjerrë disa vendime ku ka konfirmuar se kërkesat e përshtatshmërisë duhet të përmbushen nga të gjithë anëtarët e GOE dhe këto

kërkesa nuk aplikohen ndaj GOE si tërësi. Prandaj pretendimet janë të pabazuara. Sa i përket pretendimeve të tjera ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit, duhet sqaruar se parashtruesi përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme por edhe tenderuesit e tjerë janë eliminuar si të papërgjegjshëm. Në fakt i gjithë aktiviteti i prokurimit është anuluar në mungesë të ofertave të përgjegjshme. Rrjedhimisht parashtruesi nuk mund të dëshmojë asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë tanimë të eliminuar si të papërgjegjshëm. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, parashtruesi nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nën paragrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nën paragrafin d) të Rregullores nr. 001 / 2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 05/08/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0692/2024, ndërsa me datë

17/08/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0692 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Samire Osmani eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0692 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim për PSH: GOE ankues ne këtë ankese ka pretendime ankimore edhe ndaj OE pjesëmarrës OE Doctor Extermintor Ddd Sh.P.K & Ddd Sh.P.K Si Dhe Ndaj Trully Nolen Sh.P.K. Eksperti shqyrtues sqaron se të dy GOE ndaj te cilëve ka pretendime GOE ankues janë te eliminuar dhe nuk e kane ankimuar vendimin e AK-se për anulimin e aktivitetit te prokurimit prandaj vlerëson se meqenëse janë pajtuar me vendimin e AK-se atëherë GOE ankues ne lidhje me tenderuesit ndaj te cilëve ka pretendime nuk është palë e interesuar sipas nenit është 4 paragrafi 1.26 i LPP-se, rrjedhimisht as pretendimet ankimore ndaj tyre nuk do të shqyrtohen.

Konstatimi i pare (I) : “Lidhur me pretendimin e GOE ankues qe ka te bëjë me kërkesat sipas FDT është kërkuar: 3.Operatori Ekonomik duhet te jete i licencuar nga MBZHR për kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit të Republikës së Kosovës 3. Kopja e licencës valide. GOE ankues i përberë nga “Samire Osmani; Besim A. Zejnullahu B.I.; VLORA A.AHMETI B.I.; N.P.SH. BREDHI” kane dorëzuar me oferte licencën valide me nr. Ref. 04.5-242/24 te datës 05.04.2024 në emër te Liderit te konsorciumit Samire Osmani B.I. AK në njoftimin për vendim njëra ndër arsyet e eliminimit te GOE ka qenë mosplotësimi i këtij kriteri nga të gjithë anëtarët e grupit te OE-ve duke ju referuar nenit 26.4 te RRPP 001/2022. AK edhe gjate përgjigjes ne kërkesën për rishqyrtim ka përdorur te njëjtën arsyetim te eliminimit se kërkesa e FDT është ne kuadër te kërkesave te përshtatshmërisë sipas nenit 26.4 te RRPP 001/2022 lidhur me nenin 65 te LPP-se. Eksperti shqyrtues pas administrimit te provave; dosja e tenderit, oferta e GOE ankues,

interpretimit të KRPP-se në kërkesën e GOE ankues, RRPP 001/2022 si dhe LPP-se sqaron se Neni 26.4 i RRPP lidhur me nenin 65 të LPP-se të cilit i referohet AK gjatë eliminimit të GOE nuk ka të bëjë me kërkesat për të cilat është eliminuar GOE ankues. Kërkesa e AK-se ka të bëjë me nenin 26.5 të RRPP-se lidhur me nenin 66.2 të LPP-se. 26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzojë Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Arsyetimi i dhënë nga AK mbi eliminimin e GOE në këtë pikë është në kundërshtim me nenin 26.5 lidhur me nenin 66.2 të LPP-se dhe se eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka vepruar në kundërshtim me Nenin 7 dhe 59 të LPP-se dhe se pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Konstatimi i dytë (II) : “Lidhur me pretendimin e GOE ankues që ka të bëjë me kërkesat e FDT-se është kërkuar: 4. Leja për importim të produkteve biocide nga MMPH 4. Kopje e Lejes për importim të produkteve biocide preparatet duhet të jenë konform lejes së importit. GOE me oferte ka dorëzuar lejen për import të produkteve me nr. Ref. 24/1855/1-ZSP/23/ në emër të anëtarit të konsorciumit EKO DDD i lëshuar me datën 20.2.2024. AK e ka eliminuar me të njëjtin arsyetim sikur në pretendimin e parë. Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi këtu ka të bëjë me të njëjtin rast sikur në pretendimin e parë dhe rrjedhimisht vlerëson se arsyeja e eliminimit sikur në pretendimin e parë, po ashtu shkeljet janë të njëjta kështu që vlerësimi dhe eliminimi nuk është bërë në përputhje me RRPP dhe rrjedhimisht edhe ky pretendim është i bazuar.

Konstatimi i tretë (III) : “Lidhur me pretendimin e GOE ankues që ka të bëjë me kërkesat e FDT-se është kërkuar: 5. Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO standard 9001 2015, 14001 2015, 45001 2018. 5. Kopja e certifikatave - valide dhe të noterizuara. GOE me ofertë ka dorëzuar ISO standardet ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001 të gjitha valide për anëtarin e grupit Besim Zejnullahu (Eko DDD), si dhe ISO standardet ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001 të gjitha valide për anëtarin tjetër të grupit Samire Osmani BI (Eco Pastrimi DDD), por nuk ka dorëzuar ISO standarde për anëtarin e trete (Vlora Ahmeti BI) dhe të katërt të grupit (NPSH Bredhi). Eksperti shqyrtues vlerëson se pavarësisht se GOE e ka kundërshtuar arsyen e eliminimit duke u bazuar në të njëjtin arsyetim si në pretendimet me lartë në këtë rast RRPP 001/2022 e përcakton qartë se si duhet të trajtohet ky rast. Standardet për sigurimin e cilësisë janë të përshkruara me nenin 70 të LPP-se dhe sipas RRPP 001/2022 nenit 26.6. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standarde përkatëse. Prandaj bazuar në kërkesat e RRPP 001/2022 secili anëtar i GOE në këtë rast duhet të dëshmojë se i përmbush kërkesat sipas nenit 26.6. Eksperti shqyrtues sqaron se UOPP 001/2023 neni 10 paragrafi 1 citoj “Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së”. Prandaj bazuar në argumentet e mësipërme eksperti shqyrtues

vlerëson se AK në këtë rast është dashur të veproj ne përputhje me Nenin 72 dhe nenin 59.2 te LPP-se dhe të kërkojë sqarime nga GOE, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e 34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës -RITENDER me numër të prokurimit 616-24-4214-2-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës me shumicë votash ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull 34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës - RITENDER me numër të prokurimit 616-24-4214-2-1-1, të mbetet në fuqi vendimi i AK-se për anulimin e këtij aktivitetit të prokurimit, ndersa ankesen e OE ankues e aprovon si pjesërishtë sit ë bazuar për arsye se pretendimi 1 dhe 2 i bazon , ndersa pretendimi 3 i pa bazuar dhe nuk e mbështet ekspertin i cili thot të kërkohe sqarime deri sa ankuesit të cilit i takon edhe barra e provës nuk ka ofruar këto qertifikata as në kërkesë për ri-shqyrtim dhe as në Ankesë, dhe neni 72 nuk ka karakter obligues dhe detyrues për AK, për derisa nuk ka edhe argumente. Andaj AK-ja në këtë rast ka vepruar konform dispozitës nr. 26.6 të RrPP Nr. 001/2022, si dhe interpretimit e KRPP Nr. 29 të publikuar në platformën e e-prokurimit me dt. 22.06.2023 ndër tjerash citon: “Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, “Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse”. Pasi që, Kërkesa e DT dhe njoftimit për kontratë është “Operatori Ekonomik duhet te jete i çertifikuar me ISO 9001, për Panelin Shqyrtues është fakt notor se kjo kërkesë ka të bëjë me operatorin ekonomik e cila në mënyrë automatike kategorizohet si kërkesë e nenit 70 dhe të cilën duhet ta ofrojnë të gjithë anëtarët e grupit. Andaj, në konsistencë edhe me vendimet tjera të OSHP për raste të ngjashme edhe në këtë rast Paneli Shqyrtues e mbështet AK.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë

një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Samire Osmani**
- Arkivës së OSHP-së: